



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:041426

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05642318

KPPP.nr.1049/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbare të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” SH.A., me adresë në Prishtinë, kundër debitorit “NTP AHMED - FARUK” O.P., me NUI: 810563082, me seli në Lipjan, rruga “Ukshin Kovaçica”, duke vendosur lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm CPP.nr.133/16 të datës 26.10.2018, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm CPP.nr.133/16 të datës 26.10.2018.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.1049/23 në çështjen përmbare të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” SH.A., kundër debitorit “NTP AHMED - FARUK” O.P., vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Kjo gjykatë ka vendosur në punë lëndën si në këtë çështje pas marrjes së aktvendimit nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.515/23 dhe pas

administrimit të shkresave të lëndës, konform dispozitës nga neni 17.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore (tutje LPK) lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbimore vlerëson se kjo çështje nuk bie nën juridiksionin e kompetencës lëndore të Gjykatës Komerciale.

Sipas Nenit 13 par. 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale përcaktohet se kjo gjykatë është kompetente për të gjykuar *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;”* ndërsa me par. 1.2 të këtij ligji përcaktohet kompetenca dhe juridiksioni për *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Referuar dispozitave ligjore të lartcekura, meqenëse propozimi për përmbirim i kreditorit i lejuar me Aktvendimin për përmbirim të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.133/16 të datës 17.01.2022, nuk paraqet mjet juridik në procedurën përmbimore, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike vlerëson se kjo çështje juridike përmbimore nuk bie nën juridiksionin e kompetencës lëndore të saj, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për çka shkresat dhe dosja e lëndës i delegohet në tërësi Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje përmbimore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1049/23, datë 30.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.